



UNICEF
SHQIPËRI


PROJEKTI CLEEN: FLETORJA E NXËNËSIT KLASA E TRETË

Pergatitur nga: Raiha Idrees

Emri im është _____

**Une dua qe Shqiperia ime te jete e bukur dhe
e paster**

UJI



**PËRDORENI
UJIN
ME KUJDES**

Tema: Cikli i Ujit


Aktiviteti # : Një

Aktiviteti: Studim social

Materiale: Lapsa, lapustila me ngjyrë, shënjes

Hapi fëmijë-fëmijë: Të kuptuarit

Më poshtë është një pikturë e ciklit të ujit. A mund ta ngjyrosni pikturën dhe të shpjegoni ç'po ndodh në të?



Tema: Uji

Aktiviteti #: Dy

Aktiviteti: Anketë


Materiale: laps ose stilolaps, lapustila dhe tabakë letre

Hapi fëmijë-fëmijë: Zbulimi i fakteve

E keni llogaritur sa ujë pini në ditë? A e dini sa ujë duhet të pini në ditë? A doni të bëni një anketë që të masni sa ujë pini çdo ditë ju dhe të afërmit tuaj? Po gjatë një jave të tërë? Pasi të plotësoni tabelën, bëni një grafik të thjeshtë që tregon sa ujë pi secili antar i familjës tuaj gjatë një jave. Më poshtë jepet një model për t'ju ardhur në ndihmë.

Antarët e familjes	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte	E shtunë	E dielë
Babai							
Nëna							
Vëllai							
Motra							
Unë							

Gotat me uje qe kemi pire ne shtepine tone per nje jave



Tema: Manaxhimi i ujit

Aktiviteti #: Tre

Aktiviteti: Bëhuni "Detektivë uji"

Materiale: Rubinet, orë dore ose tavoline a muri, një copë letër, laps, një filxhan çaji, kovë, vadi tëse lulesh

Hapi fëmijë-fëmijë: Zbulimi i fakteve

Gjeni sa ujë derdhet kot në një ditë nga një rubinet që rrjedh. Zbuloni se mos ka ndonjë rubinet që rrjedh në shtëpinë tuaj.

Për këtë:

1. Hapni një rubinet shumë pak, aq sa të rrjedhë ujë. (nëse në shtëpi keni një rubinet që rrjedh, përdorni atë).
2. Shënoni orën.
3. Vendosni kovën nën rubinetin që rrjedh. Lëroni aty për një orë, pastaj hiqeni kovën që aty (dhe mbyllni rubinetin nëse është i rregullt dhe nuk rrjedh).
5. Mbushni filxhanin duke e futur në kovë.
6. Hidheni ujin e filxhanit në një ujitëse lulesh. Shkruani sasinë e ujit që hodhët.
7. Vazhdoni të hidhni ujë dhe ta matni deri sa të zbrazet kova.
8. Numëroni filxhanët e ujit (Nëse ngatërroheni, përsëriteni edhe një herë nga fillimi hedhjen e ujit me filxhanë nga kova në vadi tëse)
9. Shumëzoni numërin e filxhanëve të ujit të mbledhur në një orë me 24 orë në ditë. Shikoni sesa filxhanë uji mund të ketë në një bidon ujë, pastaj pjestojeni këtë numër me numërin e filxhanëve të



ujit që mbledhët për të gjetur sesa bidonë ujë harxhet nga një rubinet i prishur në ditë. Përdoreni ujin që keni hedhur në vadi tëse për të ujitur lulet apo bimët që keni mbjellë në shtëpi.

10. Kontrolloni mos keni rubineta të prishur në shtëpi (mos harroni edhe rubinetat jashtë shtëpisë).

MOS HARRONI! Flisni me të rriturit për rregullimin e rubinetave të prishur. Zakonisht duhet vetëm të ndërroni gominën.

Tema: Uji i pastër dhe i ndotur

Aktiviteti #: Katër


Aktiviteti: Eksperiment: Pastrimi i ujit të ndotur

Materiale: Letër kuzhine, gërshërë, hinkë, 2 gota ose kavanozë, lugë, ujë

Hapi fëmijë-fëmijë: Planifikimi dhe realizimi

Ne mund ta pastrojmë ujin nga ndotja!

Një nga mënyrat për të pastruar ujin e liqenit quhet *filtrim*. Si bëhet filtrimi? Ta shohim!



1. Nga letra e kuzhinës, prisni një rreth. Paloseni përgjysëm, pastaj prapë përgjysëm.
2. Hapeni rrethin e palosur për të bërë një hinkë prej letre.
3. Vëreni hinkën prej letre brenda hinkës së vërtetë dhe vendoseni në një gotë apo kavanoz.
4. Mbusheni kavanozin me ujë.
5. Shikojeni ujin që del nga hinka.
6. Hiqeni hinkën prej letre dhe shikojeni me kujdes.
7. Çfarë vini re ?

A është letra e ndotur? Një hinkë e mbushur me rërë vepron si filtër. A është i qartë uji në fund të kavanozit? Apo vazhdon të jetë pak i turbullt? Arsyeja është se në impiantet e pastrimit të ujit përdoren disa metoda filtrimi, jo vetëm një. A mendoni se filtri prej rëre heq bakteret nga uji? (Mendoni sa të vogla janë bakteret)

Ku gjendet impianti më i afërt i pastrimit tek ju? Si filtrohet uji? Nga e dini se uji që pini është i pastër dhe pa baktere? Çfarë sëmundjesh merrni po të pini ujë të ndotur? Si mund ta pastrojmë ujin në shtëpi?

(shih aktivitetet fëmijë-fëmijë për ujin e ndotur në faqet 54, 55 dhe 56)

Tema : Ruajtja e Ujit

Aktiviteti # : Pesë

Aktiviteti: Të gjejmë në është e vërtetë apo e rreme dhe të bëjmë një poster

Materiale: lapsa/pena, poster/tabakë letre, shënjes, bojë

Hapi fëmijë-fëmijë: Përsëritje

1. _____ Sot në botë ka po aq ujë sa kishte edhe miliona vite më parë.
2. _____ Afërsisht 97 % e ujit të botës është i kripur dhe nuk pihet. 2 për qind është i bllokuar në akullnaja. Pra, mbetet vetëm 1% për t'u përdorur nga ne.
3. _____ Uji nuk e rregullon temperaturën e tokës.
4. _____ Sasia më e madhe e ujit nëpër shtëpitë tona harxhohet në banjo.
5. _____ Një rubinet i prishur nuk harxhon edhe aq shumë ujë sa na duket neve.

Ruajtja e ujit është shumë e rëndësishme. Mund të bëni një poster ku të bëni thirrje për ruajtjen e ujit. Në posterin tuaj mund të vini një nga mesazhet e mëposhtme:

- Mbyllni ujin në kohën që lani dhëmbët.
- Bëni dush shpejt.
- Mos e mbani çezmën hapur gjatë gjithë kohës kur lani apo shpëlani enët.
- Pastrojini anët e trotuareve dhe të rrugëve me fshesë, jo me zorrë uji!
- Ujiteni kopshtin herët në mëngjes për të shmangur avullimin.
- Rregulloni rubinetat që rrjedhin.

Bëni një poster interesant dhe sa më tërheqës. Kur ta keni mbaruar, tregojuni shokëve dhe njerëzve të shtëpisë.

Ajri



Tema: Ç'është ajri?


Aktiviteti #: Një

Aktiviteti: Cikli i oksigjenit

Materiale: Pena, lapsa, shënjuesa

Hapi fëmijë-fëmijë: Të kuptuarit

Ajri është i rëndësishëm për të gjitha gjallesat. Pse është i rëndësishëm ajri dhe pse ne kemi nevojë të thithim ajër të pastër? Më poshtë jepet një diagramë e ciklit të oksigjenit. A mund të shkruani disa fjali që shpjegojnë se ç'po ndodh në diagramë? Pse është ajri i rëndësishëm dhe pse duhet që ai të jetë i pastër?



Tema: Ndikimi mbi shëndetin

Aktiviteti #: Dy

Aktiviteti: Përdorimi i mushkërive tona

Materiale: Pikturë e mushkërive, pikturë e tortës së ditëlindjes, pikturë e një filxhani me çokollatë të nxehtë, tollumbace, një pupël, lapsa me ngjyra, shirit ngjitës.

Hapi fëmijë-fëmijë: Zbulimi i fakteve

Mësojuni fëmijëve rëndësinë e mushkërive dhe dëmin që shkaktojnë tymrat që thithin.


Aktiviteti:

Hapi 1: Fëmijët ngjyrosin pikturën e mushkërive, tortën e ditëlindjes dhe çokollatën e nxehtë. Në kohën që ata ngjyrosin, shpjegojuni sesi mushkëritë marrin ajër dhe e nxjerrin atë. Tregojuni ku gjenden mushkëritë në organizëm.

Hapi 2: Pritini pikturat dhe më pas ngjitni një copë shirit ngjitës tek mushkëritë. Ndhmohjini fëmijët që t'i ngjisin mushkëritë në trup. Kërkojuni të marrin frymë thellë dhe të bëjnë sikur fikin qirinjtë mbi tortën e ditëlindjes. Pastaj u thoni të bëjnë sikur i fryjnë çokollatës së nxehtë për ta ftohur.

Hapi 3: Jepini çdo fëmijë një tullumbace dhe u thoni që t'i fryjnë.

Hapi 4: Jepini çdo fëmijë një pipëz dhe një pupël dhe u thoni që t'i fryjnë puplës me anë të pipzës për ta mbajtur puplën në ajër sa më gjatë.



Tema: Ajri



Aktiviteti #: Tre

Aktiviteti: Të bëjmë një aeroplan

Materiale: Letër dhe imagjinatë


Hapi fëmijë-fëmijë: Planifikimi dhe realizimi

SHPIKËSI




1. Gjeni një fletë të hollë letre, rreth 2.5 me 15 cm ose një fletë më të trashë rreth 4 cm 25 cm dhe paloseni


përgjysëm.



2. Tani, me kujdes palosni dhe çpalosni një cep në formë trekëndëshi dhe ktheheni atë drejt qendrës. Baza e trekëndëshit duhet të jetë sa rreth $\frac{3}{5}$ e gjerësisë.




3. Palosni ato që do të shërbejnë si "krahë".



4. Dhe shtrijeni letrën në vendet e palosura (por jo duke i shtrirë vijat plotësisht).

Aeroplani prej letre




Aeorplani prej letre fluturon lehtë dhe bëhet lehtë. Ai fluturon ngadalë dhe pa u ndjerë. Dhe nuk prishet për disa kohë. Është modeli më i mirë i aeroplanit prej letre që mund të bëhet sepse është bëhet me lehtësi dhe rezultati është i mahnitshëm.


Pra, meqenëse është i lehtë për t'u

bërë, kërkojmë falje që e shpjeguem si bëhet në detaje, por qëllimi është që të gjithë ta mësojnë si bëhet pa asnjë vështirësi, duke kaluar nga njëri hap tek tjetri.


Mbani mend që një vijë e thjeshtë e ndërprerë me viza është një "luginë" (letra thellohet përgjatë asaj vije dhe ngrihet në të dy anët e saj) dhe një vijë e ndërprerë me viza dhe me me pika është një ngritje "mali" (letra ngrihet përgjatë asaj vije) Për të mësuar punime me letër shihni Tetë palosjet ose Wikipedia.




1. Merrni një fletë letre 20 me 25 cm dhe paloseni në mes përgjatë gjatësisë sipas vijës së ndërprerë me viza (lulina) siç tregohet në pikturë dhe hapeni prapë.




2. Pas kësaj, rezultati i një palosjeje do të tregohet bashkë me hapin tjetër dhe me udhëzimet e mëtejshme.




3. Tani palosni cepat lart nga brenda drejt vijës së qendrës gjatë vizës që tregon “palosjen e luginës” duke krijuar dy këndë të reja këndrejta siç tregohet në ilustrimin 4.



4. Paloseni trekëndëshin lart (që krijohet nga dy trekëndëshat e vegjël që sapo bëtë në Hapin 3) dhe shtypeni poshtë.



5. Palosni pjesën e poshtme të trekëndëshit të madh. Por jo gjithë trekëndëshin, vetëm majën siç tregohet në figurë.



6. Lini rreth 1 cm hapësirë nga maja.
Kjo do të bëjë që pala të rrijë e
puthitur dhe aeroplani të rrijë i
mbledhur kur ta kemi mbaruar.

Tema: Era

Aktiviteti #: Katër

Aktiviteti: Era

Materiale: Lapsa/pena

Hapi fëmijë-fëmijë: Përsëritje

A dëgjoni erën? E ndjeni atë? Po të ishit erë, ku do të shkonit? Çfarë do të bënit? Çfarë do të shihnit? Kë do të ndihmonit? Do të ishit një puhi e lehtë freskuese apo erë e fortë në det? Shkruani një paragraf me temën **"Sot jam erë dhe ja se çfarë do të bëj"**

TOKA



Tema: Shkretëtira/Pylli tropikal dhe Uji i freskët

Aktivitet #: Një

Aktiviteti: Punë me shkrim

Materiale: lapsa, letër

Aktiviteti fëmijë-fëmijë: Të kuptuarit

Shikoni pamjet më poshtë. Përdorni mbiemra (fjalë që përshkruajnë) për të shprehur atë që shihni. Si do të ishte po të jetonit në një vend të tillë? Si do të ndiheshit? Si do të ishin temperaturat?







Tema: Ç'është bota?

Aktiviteti #: Tre

Aktiviteti: Të bëjmë nuse pashke

Materiale: Gurë të lëmuar të formë të rrumbullakët dhe ovale, të larë e të pastruar; bojë akrilike në ngjyra të ndryshme, bojë akrilike e zezë e fortë, 2 sy të vegjël të rrumbullakët të marrë nga ndonjë lodër e prishur, shënjes i zi me majë të hollë, ngjitëse e fortë .

Hapi fëmijë-fëmijë: Zbulimi i fakteve



Shikoni sa të bukura këto nuse pashke. Mund të bëni ca nga këto për t'i përdorur si zbukurime, ose bëni një nuse pashkë të madhe që ta vendosni mbi fletët e letrës që të mos i marrë era. Edhe pse në realitet ato janë të kuqe, ne mund t'i bëjmë në të gjitha ngjyrat. Zgjidhni ngjyrën që ju pëlqen më

shumë!

Si bëhet një nuse pashke :

1. Pastrojmë, lajmë dhe thajmë gurët e vegjël.
2. I lyejmë me ngjyrën që na pëlqen dhe i lemë të thahen. U japim një dorë të dytë e të tretë po qe nevoja. Ngjyrat e çelëta duan më shumë duar se ngjyrat e errëta.
3. Lyeni kokën duke përdorur bojë akrilike të zezë të fortë. Nuk ka ndonjë rregull të veçantë, thjesht lyeni afërsisht $\frac{1}{4}$ e gurit në fillim të tij.

4. Përdorni një shënjes me majë të hollë për ta ndarë gurin më dysh duke filluar nga qendra e kokës e deri në fund të trupit.
5. Futni në bojë të zezë, majën e gomës së një lapsi. Bëni me të pikat e zeza të nuse pashkës. Pas çdo pike, lyejeni prapë gomën.
6. Kur të thahet boja, lyejeni çdo nuse pashke me spërkatës llaku. Lëreni të thahet plotësisht.
7. Duke përdorur ngjitëse, vendosni sytë dhe lërinë të thahen.

Këshilla:

- Gurët e vegjël janë më të lehtë për t'u punuar nga fëmijët. Por ata janë më të rëndë dhe bëni kujdes që të keni disa ndihmësa për fëmijët në këtë aktivitet.
- Në vend të syve plastikë që rrotullohen, mund të përdorni bojë të bardhë dhe të zezë për t'i vizatuar. Bëni në fillim të bardhën e syrit dhe më pas një pikë të vogël të zezë.

Tema:: Ngrohja globale

Aktiviteti#: Katër

Aktiviteti: Të mbjellim pemë

Materiale: Pemë (bimë) dhe vazo.

Aktivitet midis fëmijësh: Planifikimi dhe realizimi

- Një mënyrë për të penguar ngrohjen globale është të mbjellim pemë. Pemët thithin dioksidin e karbonit që gjendet në ajër dhe kufizojnë ndotjen e tij.

Caktoni objektivat:

- Vendosni pse duhet të mbillni pemë.
- Kë doni apo keni nevojë të fusni në projektin tuaj.
- Përfshijini të gjithë që në fillim.



Zgjidhni një vend të përshtatshëm :

Provoni dheun. Disa pemë rriten më mirë në toka të thata ranore dhe të tjerat në toka me lagështirë. Çdo pemë ka nevojat e veta për t'u rritur.

Bëni një hartë:

Bëni një hartë të vendit që keni zgjedhur duke caktuar vendet ku do të mbillni pemët.

Zgjidhni llojet e pemëve:

- Zgjidhni pemë që janë të përshtatshme për strukturën e dheut të vendit që keni zgjedhur.
- Zgjidhni pemë që rriten në zonën tuaj sepse këto i përshtatën më mirë ajrit dhe dheut të zonës.
- A do të jetë pema një vend i sigurtë për zogjtë dhe kafshët që do të jetojnë aty?
- Pemët e reja me rrënjë të formuara kanë më shumë shanse për të mbirë, por fidanët e vegjël dhe kaçubet e vogla janë më të lehta për fëmijët.

Tema: Bukuritë e tokës

Aktiviteti #: Pesë

Aktiviteti: Të bëjmë një kartolinë

Materiale: Lapsa me ngjyra, skedë në përmasat e kartolinës, adresa e shtëpisë, pullë poste.

Aktivitet midis fëmijësh: Planifikimi dhe realizimi



A e dini ç'është kartolina? Këto janë modele kartolinash. A mund të bëni ju një kartolinë që të tregojë bukuritë e tokës? Mund të shkruani në të një mesazh për të ruajtur botën ku jetojmë dhe ta dërgoni në adresën e shtëpisë tuaj.



Tema: Ndotja e tokës

Aktiviteti #: gjashtë

Aktiviteti: Të flasim për ndotjen

Materiale: Laps, penë e lapsa me ngjyrë

Aktivitet midis fëmijësh: Përsëritje

Bëni sikur jeni pemë. Gjendeni në një pyll, por nuk jeni si gjithë pemët e tjera, jeni pemë e veçantë. E veçanta juaj është se në degët tuaja rriten qese plastike. A ju kanë zili pemët e tjera që bëni qese plastike? Si është jeta juaj? Ç'mendojnë banorët e zonës për ju? Jeni pemë e lumtur apo e dëshpëruar? Shkruani një tregim për veten tuaj, d.m.th. për pemën që bën qese plastike.

NATYRA



TEMA: Ç'është natyra?

Aktiviteti #: Një

Aktivitet: Të vemë etiketa

Materiale: lapsa

Hapi fëmijë-fëmijë: Të kuptuarit

Të vemë etiketat e anatomisë së pemës
përkufizimet, më pas etiketoni diagramën e pemës më poshtë.


Lexoni

degët – pjesët e drunjtë të pemës së dalin nga trungu i saj.

mbulesa e gjethëve – pjesa e sipërme e pemës ku gjenden gjethet

rrënjët – strukturat që marrin ushqim dhe ujë nga toka, ruajnë energjinë dhe mbajnë pemën në këmbë. Në më të shumtën e rasteve rrënjët janë nëntokë.

trungu – mbajtësi kryesor i pemës.



Tema: Ç'është natyra?


Aktiviteti #: Dy

Aktiviteti: Vizatim

Materiale: Lapsa me ngjyra, shënjes, pemë, letër e hollë, shirit ngjitës

Hapi fëmijë-fëmijë: Të kuptuarit

Të pikturojmë mbi lëvozhgën e pemës



Mund të bëjmë
vizatime
interesante
duke fërkuar
një letër të
hollë të
vendosur mbi
lëvozhgën e
pemës me lapsa
me ngjyrë...

Ngjitni letrën e hollë mbi trungun e pemës dhe me kujdes përdorni mbi të lapsa të trashë me ngjyrë. Kjo teknikë jep rezultate shumë të mira mbi lëvozhgën e pishës, ahut, qershisë së egër dhe arrës. Çfarë zbuluat pasi kryet këtë veprim. A ndryshojnë shumë gjurmët e lëna nga lëvozhgat e ndryshme? A mund të përcaktohet lloji i pemës nga gjurmët e lëna prej fërkimit mbi letrën e hollë?

Tema: Natyra

Aktiviteti #: Tre

Aktiviteti: Të studjojmë një mur të vjetër

Materiale: Letër, laps, lapsa me ngjyra, fletë vizatimi

Hapi fëmijë-fëmijë: Zbulimi i fakteve

Studjoni një mur të vjetër në lagjen tuaj. Shikoni me kujdes gjurmët e jetës në këtë mur. Cilat insekte jetojnë këtu? Ç'lloj bimësh rriten në të çarat e tij? Vizatojeni murin dhe ngjyroseni atë. A u çuditët nga ato që zbuluat në murin e vjetër?

Tema: Natyra

Aktiviteti #: katër

Aktiviteti: të studjojmë bukuritë e natyrës së vendit tonë

Materiale: Letër, laps, lapsa me ngjyrë, hartë të Shqipërisë, letër vizatimi

Hapi fëmijë-fëmijë: Zbulimi i fakteve

Më poshtë është një hartë e Shqipërisë. A mund të emërtoni në këtë hartë vendet me bukuri natyrore si pyje, parqe, liqene dhe male?



Tema : Ekosistemet

Aktiviteti #: Pesë

Aktiviteti: Të kuptojmë zinxhirin e ushqimit

Materiale: Lapsa, lapsa me ngjyrë, letër

Hapi fëmijë-fëmijë: Planifikimi dhe realizimi

Hidhni sytë përreth. A shihni ekosisteme dhe zinxhirë ushqimorë? A mund të tregoni për një zinxhir ushqimor që e keni studjuar? Bëni një zinxhir të thjeshtë ushqimor në hapësirën më poshtë.

Tema : Manaxhimi i mbetjeve

Aktiviteti #: Gjashtë

Aktiviteti: Kolazh i trupit, unë dhe projekti im

Materiale: Çanta të mëdha letre, ose një rul i madh letre, lapsa, lapsa me ngjyra, revista dhe foto të vjetra, copë, kopsa, fije për të thurur triko, ngjitës, gërshërë

Hapi fëmijë-fëmijë: Planifikimi dhe realizmi

Çfarë do të bëjmë:

1. Hapni dy çanta të mëdha letre dhe ngjitini bashkë derisa të bëni një tabak letre pak më të gjatë e pak më të gjerë sesa vetja juaj. Ose përdorni tabakë letre për të njëjtin qëllim.
2. Shtrihuni mbi letër dhe i thoni një shoku të vizatojë format e trupit tuaj mbi letër.
3. Priteni formën e trupit tuaj.
4. Gjeni pamje të gjërave që ju pëlqejnë në revista. Pritini dhe ngjitini mbi vizatimin e trupit tuaj. Mund të jetë çdo gjë që ju pëlqen: piktura kafshësh, makina, grupe muzikore, kompjutera, etj.
5. Vizatoni fytyrën, këpucët, e të tjera gjëra tuajat duke përdorur lapsin dhe lapsat me ngjyra. Mund të ngjisni edhe copa të ndryshme, në formën e veshjeve, në kolazhin e trupit tuaj.
6. Vareni kolazhin mbi një derë.

Tema: Vlerësimi i natyrës

Aktiviteti #: shtatë

Aktiviteti: Krijim artistik, album me pamje nga natyra

Materiale: Letër, ngjitës, gërshërë, revista e gazeta të vjetra.

Hapi fëmijë-fëmijë: Përsëritje

Bëni një album me bukuritë e natyrës në Shqipëri. Prisni pasmje nga revistat e vjetra dhe përdorni kartolina me pamje nga natyra e bukur e vendit tonë. Tregojani librin shokëve dhe njerëzve të shtëpisë. Ç'mendojnë ata? E dinin që Shqipëria është kaq e bukur?

NDOTJA



Tema: Ç'është ndotja?

Aktiviteti #: Një

Aktiviteti: Krijim artistik - Të bëjmë një poster

Materiale: Tabakë letre, bojë, laps, lapustila

Hapi fëmijë-fëmijë: Të kuptuarit

Më poshtë jepen disa nga ndotësit e ujit. A mund të bëni një poster që t'u tregoni shokëve dhe prindërve se cilët janë ata faktorë që ndotin ujin dhe si ç'ndikim kanë në mjedisin tonë? Bëni një poster domethënës dhe njëherazi interesant.

Gjethë
dhe
fije
bariKimikatet
e
pishinaveLëndë të
rrezikshmeSapunë
dhe
detergentë

Pisllëqe, Letra



Kafshët



Dhe

Vajra nga
makinatTymrat e
makinavePesticidet
dhe
plehtrat

Tema: Ndotja

Aktiviteti #: Dy

Aktiviteti: Tabelë për mbledhjen e plehrave të shtëpisë

Materiale: lapsa, ngjyra, letër, tabakë letre

Hapi fëmijë-fëmijë: Zbulimi i fakteve

A keni menduar ndonjëherë ç'ndodh me plehrat pasi i nxirrni nga shtëpia? Tani keni rastin ta mësoni. Pasi të keni pyetur ca njerëz që do t'ju tregojnë ç'ndodh më tej, mund të bëni një tabelë ku të tregoni hapat që kryhen kur nxjerrim plehrat nga shtëpia, deri në fazën e fundit. Përdorni shigjetat dhe vendosni emrin e çdo procesi pune.

Tema: Ndotja e ujit

Aktiviteti #: Tre

Aktiviteti: Përshkrim: krijesa e vogël e ujit

Materiale: Laps dhe letër

Hapi fëmijë-fëmijë: Zbulimi i fakteve

A mund të bëni një tregim për ndotjen e ujit? Përfytyroni sikur jeni një krijesë uji dhe jetoni në një pell të ndotur? Çfarë gjërash keni përreth? Si ndjeheni? Cili është shkaku i ndotjes së pellgut? Si ka qenë më parë? Çfarë u ndodhi gjallesave të tjera të ujit që më parë jetonin me ty? Bëni një pikturë që ilustron tregimin tuaj.

Tema: Ndotja nga zhurma

Aktiviteti #: Katër

Aktiviteti: Të dëgjojmë

Materiale: Laps, letër

Hapi fëmijë-fëmijë: Planifikimi dhe realizimi

Uluni dhe mbyllni sytë. Përqëndrohuni në ato që dëgjoni rreth jush. Çfarë tingujsh dëgjoni? Janë të këndshëm apo të bezdisshëm? Si ju bëjnë të ndiheni? A mund të bëni një listë të tingujve që dëgjoni rrotull jush? Nga vijnë këta tinguj? Janë të mirë apo të këqinj? Bëni një listë të tingujve që ju pëlqejnë dhe të atyre që nuk ju pëlqejnë:

Më pëlqejnë:

Nuk më pëlqejnë

1. _____

1. _____

2. _____

2. _____

3. _____

3. _____

4. _____

4. _____

5. _____

5. _____

6. _____

6. _____

7. _____

7. _____

8. _____

8. _____

Tema: Ndotja

Aktiviteti #: Pesë

Aktiviteti: Kolazh artistik i ndotjes dhe ndotësve

Materiale: Letër me ngjyrë, gërshërë, revista të vjetra, tabakë letre, kopsa, copë.

Hapi fëmijë-fëmijë: Përsëritje

Do të bëni një kolazh që flet për ndotjen. A e dini ç'është kolazhi? Kolazhi është bashkimi i shumë gjërave për të krijuar një pamje interesante. Për kolazhin tuaj mund të përdorni revista e gazeta të vjetra. Më poshtë janë hapat që do të ndiqni:

1. Bëni një pikturë që ju pëlqen mbi tabakun e letrës.
2. Prisni piktura të vogla nga revista dhe gazetatat.
3. Ngjitini pamjet e prera për të plotësuar vendet bosh të pikturës dhe të tabakut të letrës.

MBESHTETUR NGA:

UNICEF ALBANIA



THE CHILD TO CHILD TRUST



AMBASADA E MBRETERISE HOLLANDEZE



MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCES

INSTITUTI I KURRIKULES DHE TRAINIMIT

MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE

ADMINISTRIMIT TE UJERAVE

